

KOSOVO TIME RELEASE STUDY

**EUROPE AND CENTRAL ASIA
TRADE FACILITATION
SUPPORT PROGRAM**



DECEMBER, 2021

KOSOVO TIME RELEASE STUDY

PREPARED FOR



PREPARED BY



WITH THE SUPPORT OF



Korporata Financiare Ndërkombëtare (IFC)

IFC është institucioni më i madh zhvillimor global i fokusuar në sektorin privat në vendet në zhvillim. Si anëtare e Grupit të Bankës Botërore (GBB), IFC-ja avancon zhvillimin ekonomik dhe përmirëson jetën e qytetarëve duke inkurajuar rritjen e sektorit privat në vendet në zhvillim. IFC-ja e arrin këtë duke krijuar tregje të reja, duke mobilizuar investitorë të tjerë, si dhe duke ndarë ekspertizën. Duke vepruar kështu, IFC-ja krijon vende pune dhe rrit standardet e jetesës, veçanërisht për të varfrit dhe të cënueshmit. Puna e IFC-së mbështet synimet e dyfishta të Grupit të Bankës Botërore për t'i dhënë fund varfërisë ekstreme dhe për të nxitur prosperitetin e përbashkët. Ky studim u krye nën drejtimin e ekipit Këshillimor të IFC-së për Krijim të Tregjeve, i cili trajton barrierat rregullatore, lehtëson dialogun për politikat rregullatore dhe angazhohet me qeveritë për iniciativat reformuese për të përmirësuar mjedisin që mundëson biznesin duke pasur parasysh mundësimin e investimeve të sektorit privat.

Programi për Mbështetje të Lehtësimit të Tregtisë për Evropën dhe Azinë Qendrore (PMLT EAQ)

Ekipi i IFC-së për Krijim të Tregjeve në Evropë zbaton Programin për Mbështetjen e Lehtësimit të Tregtisë në Evropë dhe Azinë Qendrore. Ky projekt ofron asistencë teknike për agjencitë qeveritare në mbështetje të dëshirës së vendeve të tyre për t'i përafuar më tej rregullat dhe rregulloret e tyre, si dhe kapacitetin zbatues, me kërkesat e Marrëveshjes për Lehtësimin e Tregtisë (MLT) të Organizatës Botërore të Tregtisë (OBT). Në Ballkanin Perëndimor, kjo mbështetje është në përputhje me Protokollin Shtesë 5 të Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA) dhe objektivat e lehtësimit të tregtisë të Tregut të Përbashkët Rajonal. Programi për Mbështetje të Lehtësimit të Tregtisë Globale (PMLT) financohet nga nëntë donatorë, Australia, Kanadaja, Bashkimi Evropian, Holanda, Norvegjia, Suedia, Zvicra, MB dhe SHBA.

Mohim i përgjegjësisë

Ky raport është përgatitur në mirëbesim mbi bazën e informacionit të marrë nga palët e interesit në procesin e zhdoganimit, nëpërmjet palëve të kontraktuara. Ekipi i PMLT EAQ-së nuk e siguron ose garanton saktësinë, besueshmërinë, plotësinë ose aktualitetin e informacionit në këtë dokument. Gjetjet, interpretimet dhe konkluzionet e shprehura në raport janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjen e Grupit të Bankës Botërore ose të ndonjë prej stafit të vet ose administratës së vet, si dhe nuk e detyrojnë Grupin e Bankës Botërore në asnjë mënyrë. Asgjë këtu nuk do të përbëjë ose konsiderohet të jetë një kufizim ose heqje dorë nga privilegjet dhe imunitetet e Grupit të Bankës Botërore, të cilat të gjitha janë të rezervuara në mënyrë specifike.

Mirënjohje

Zbatuesit e studimit dëshirojnë të vlerësojnë bashkëpunimin dhe mbështetjen e shkëlqyer të Administratës Doganore të Kosovës, Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, Policisë Kufitare, shpeditereve, ndërmjetësve dhe vozitësve.

Lista e akronimeve

AW – ASYCUDA World

PKK – Pika e Kalimit Kufitar

AVUK – Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë e Kosovës

IFC – Korporata Financiare Ndërkombëtare

FMN – Fondi Monetar Ndërkombëtar

DUD – Dokumenti Unik Administrativ

T1 – Dokumenti i Tranzitit Doganor

TARIK – Tarifa e Integruar e Kosovës

SMKZH - Studimi për Matjen e Kohës së Zhdoganimit

UNMIK – Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë

GBB – Grupi i Bankës Botërore

OBD – Organizata Botërore e Doganave

OBT – Organizata Botërore e Tregtisë

Përmbajtja

Lista e akronimeve	4
Studimi për Matjen e Kohës së Zhdoganimit në Kosovë	6
Hyrje.....	6
Metodologjia dhe procesi	7
Përgatitja e Studimit	7
Informimi dhe sensibilizimi i palëve të interesit	8
Testimi pilot	8
Procesi i mostrimit	8
Analiza e të dhënave.....	9
Gjetjet	9
Import	9
Eksporti	12
Konkluzionet dhe rekomandimet	14
Shtojca 1: Dogana e Kosovës sot	17
Shtojca 2: Përpunimi doganor	18
Shtojca 3: Përpunimi i importit dhe eksportit	19
Shtojca 4: Pyetësori për importin	24
Shtojca 5: Pyetësori për eksportin	32
Shtojca 6: Gjetjet e Detajuara të Studimit – Importi	38
Shtojca 7: Gjetjet e Detajuara të Studimit – Eksporti	61
Shtojca 8: Përmbledhje e Procedurave të Thjeshtëzuara.....	75

Studimi për Matjen e Kohës së Zhdoganimit në Kosovë

Hyrje

Efiçienca e performancës së Doganës dhe agjencive të tjera kufitare për zhdoganimin e mallrave që hyjnë dhe dalin nga një vend, është kontribuuese kryesore në funksionimin normal të tregtisë ndërkombëtare dhe procedurave tregtare. Megjithatë, procedurat e kontrollit të mallrave nga agjencitë kufitare shpesh përmenden si të rënda dhe që shkaktojnë vonesa. Kryerja e një analize të detajuar të kontrolleve të kryera dhe kohës që duhet për to, do të sigurojë të kuptuarit e qartë të situatës aktuale dhe në këtë mënyrë do të kontribuojë për dialog konstruktiv mes palëve të interesit për lehtësimin e tregtisë rreth mundësive për përmirësimin dhe përshtetimin e këtyre proceseve, si në nivel politikash ashtu edhe në pikat kufitare dhe терминаlet e brendshëm ku kryhen inspektimet dhe zhdoganimi.

Një metodë efektive dhe e njohur ndërkombëtarisht për të vërtetuar këto fakte është Studimi për Matjen e Kohës së Zhdoganimit (SMKZH). SMKZH-ja është një mjet dhe metodë unike për të matur në mënyrë sistematike dhe të standardizuar performancën aktuale të procedurave kufitare, përfshirë aktivitetet doganore, duke matur kohën e nevojshme për zhdoganimin e mallrave. SMKZH-ja mat aspektet relevante të efektshmërisë së procedurave operative të kryera nga Dogana dhe akterë të tjerë rregullatorë në përpunimin standard të importeve, eksporteve dhe në lëvizjet tranzit. Studimi synon t'i matë me saktësi këto elemente të flukseve tregtare në mënyrë që vendimet për përmirësimin e performancës të jenë të konceptuara mirë dhe të përshtatshme.

Neni 7.6.1 i Marrëveshjes së OBT-së për Lehtësimin e Tregtisë i inkurajon anëtarët e saj që të kryejnë Studime të tilla për Matjen e Kohës së Zhdoganimit në nenin 7.6.1 të saj: "Anëtarët inkurajohen ta masin dhe publikojnë periodikisht dhe në mënyrë të konsistente kohën mesatare të zhdoganimit të mallrave, duke përdorur mjete të tilla si, ndër të tjera, Studimi për Matjen e Kohës së Zhdoganimit i Organizatës Botërore të Doganave."

Në vitin 2021, firma konsulente UBO Consulting u ngarkua nga Korporata Financiare Ndërkombëtare (IFC) për të kryer Studimin e dytë për Matjen e Kohës së Zhdoganimit në Kosovë. Objektivi ishte dokumentimi dhe matja e llojit dhe kohës së procedurave të inspektimit dhe zhdoganimit të kryera nga Administrata Doganore e Kosovës dhe agjencitë e tjera kufitare, si dhe proceset e ndërrmarra nga palët e interesit private, siç janë shpeditërit, ndërmjetësit dhe vozitësit gjatë importit dhe eksportit nëpërmjet pikave të përzgjedhura të kalimit kufitar dhe terminaleve të brendshme. Ky raport përshkruan përgatitjen dhe zbatimin e studimit dhe gjetjet e tij. Raporti gjithashtu krahason rezultatet e vitit 2021 me ato të Studimit të parë për Matjen e Kohës së Zhdoganimit të kryer në Kosovë në vitin 2016, sërish si një përpjekje bashkëpunuese e IFC-së dhe palëve të interesit për lehtësimin e tregtisë në Kosovë, nën udhëheqjen e Administratës Doganore.

SMKZH 2021 u krye në përputhje me metodologjinë e Organizatës Botërore të Doganave (OBD) dhe të Grupit të Bankës Botërore. Studimi dokumentoi procedurat dhe mati kohën e përpunimit të trafikut rrugor tregtar që kalon nëpër pikat e përzgjedhura të kalimit kufitar (PKK) dhe терминаlet e brendshme. Për mbledhjen dhe analizën e të dhënave është përdorur softueri për SMKZH i OBD-së. Për të lehtësuar mbledhjen e të dhënave është përdorur një pyetësor i standardizuar (shih Shtojcat 5 dhe 6). Pyetësorët iu dorëzuan vozitësve të kamionëve kur mbërrinin në PKK dhe iu bashkëngjitën paketës së dokumentit (DUD ose T1) dhe qëndruan me të deri në zhdoganimin e mallrave.¹

¹ Studimi i vitit 2016 nuk ka përfshirë dërgesat që janë përpunuar në kuadër të procesit të Procedurave të Thjeshtëzuara, i cili u lejon kamionëve të kalojnë drejtpërdrejt nga PKK-ja në ambientet e importuesit dhe të dalin në treg menjëherë, ndërsa studimi i vitit 2021 i përfshin procedurat e thjeshtëzuara.

Mbledhja e të dhënave është bërë pas deklaratave doganore. U përdorën regjistrues për të siguruar që pyetësorët të plotësoheshin – ose duke e tërhequr në çdo hap dhe duke plotësuar pjesën e duhur ose thjesht duke u siguruar që plotësimi të ishte bërë nga zyrtarët përkatës të agjencisë kufitare dhe agjentët doganorë/shpeditarët.

U krijua një ekip për futjen e të dhënave për të futur të dhënat e mbledhura në softuerin për SMKZH të OBD-së.

Një pilot SMKZH u krye nga 8 nëntori deri më 10 nëntor 2021. Mbledhja aktuale e të dhënave për SMKZH-në u krye mes datave 15 – 20 nëntor 2021, në PKK Kosovë/Shqipëri (Vermicë); PKK Kosovë/Maqedoni (Hani i Elezit); PKK Kosovë/Serbi (Merdare); Terminali i Brendshëm Hani i Elezit; Terminali i Brendshëm Prizren; Terminali i Brendshëm Prishtinë dhe Terminali i Brendshëm Ferizaj. Këto pika të kalimit kufitar dhe terminalet e brendshme përfaqësojnë 5 terminalet kryesore me volumin më të madh në vitin 2021.

Metodologjia dhe procesi

Fazat e ndjekura për kryerjen e Studimit për Matjen e Kohës së Zhdoganimit në Kosovë ishin:

1. Përgatitja e Studimit duke përfshirë hartëzimin e procesit, zhvillimin e mjeteve të studimit dhe marrjen e mostrave
2. Informimi dhe sensibilizimi i palëve të interesit duke përfshirë iniciativat për marrëdhëniet me publikun
3. Testimi pilot
4. Kryerja e vetë Studimit
5. Analizimi dhe vërtetimi i të dhënave pasuar nga pastrimi i të dhënave
6. Përgatitja e raportit me gjetjet dhe rekomandimet kyçe

Për përgatitjen dhe zbatimin e studimit dhe për regjistrimin dhe analizën e rezultateve të tij u përdorën “Udhëzuesi për matjen e kohës së nevojshme për zhdoganimin e mallrave versioni 3” i OBD-së dhe softueri i OBD-së.

Përgatitja e Studimit

Kjo fazë përfshiu rishikimin e pyetësorëve, përcaktimin e fushëveprimit dhe dizajnit të Studimit (metodologjia, mostrimi etj.) dhe hartëzimin e proceseve të ndryshme.

Regjistruesit ndihmuan në realizimin e SMKZH-së. Roli i tyre ishte:

- Të ndihmonin në mbledhjen e të dhënave të kërkuara
- Të siguronin që të gjithë formularët e pyetësorit të plotësoheshin në plotësi dhe saktë

Pikat e kalimit kufitar në mbarë Kosovën janë të hapura 24 orë në ditë, por orari i punës së terminalit doganor për zhdoganim është nga ora 8:00 deri në 18:00. SMKZH-ja u zbatua për një periudhë prej gjashtë ditësh të rregullta pune, nga e hëna në të shtunë, kur funksionojnë terminalet e brendshme. Studimi për Matjen e Kohës së Zhdoganimit u realizua mes datave 15-20 nëntor, nga ora 8:00 deri në 12:00 në PKK-të me Maqedoninë, Shqipërinë dhe Serbinë, dhe nga ora 8:00 deri në 18:00 në terminalet e brendshme të vendosura në Prizren, Prishtinë, Ferizaj dhe Hani i Elezit.

Hartat e proceseve të punës që detajojnë procedurat e importit, eksportit dhe tranzitit, u zhvilluan për të gjitha PKK-të dhe terminalet e brendshme të përfshira në studim. Hartat e procesit u validuan

nga Dogana, ashtu si edhe pyetësorët. Bazuar në këto harta, pyetësorët u rishikuan pak për të mbledhur të dhëna mbi proceset e importit dhe eksportit.

Pyetësorët u dizajnuar për të kapur të dhënat kohore për procedurat e përpunimit sipas radhës që ato ndodhin dhe për të regjistruar kohën e përdorur nga AVUK për aprovimin e një aplikacioni. SMKZH është një mjet dhe metodë unike për matjen e performancës aktuale të agjencive kufitare, pasi ato lidhen drejtpërdrejt me lehtësimin e tregtisë në kufi. SMKZH mat aspektet relevante të efektshmërisë të procedurave operacionale që kryhen nga akterët rregullatorë në përpunimin standard të importeve, eksporteve dhe në lëvizjet tranzit: studimi mat kohën e përdorur nga zyrtarët e agjencive të kontrollit kufitar të vendosur fizikisht në pikat e kalimit kufitar dhe/ose pikat e zhdoganimit në brendësi që përfshihen në zbatimin e rregulloreve të tyre për mallrat – për shembull koha e përdorur nga autoritetet e inspektimit për ekzaminimin fizik të dërgesave për të siguruar që mallrat janë në përputhje me kërkesat sanitare, veterinare ose fitosanitare të vendit.

Informimi dhe sensibilizimi i palëve të interesit

Më 11 dhe 28 tetor 2021, u mbajt një seancë informuese për përfaqësuesit e Doganës së Kosovës, agjencive të tjera kufitare, operatorëve të terminaleve si dhe shpeditereve. Pjesëmarrësve iu shpjeguan në detaje qëllimi i SMKZH-së dhe metodologjia e OBD-së. U shpjegua se SMKZH është një metodë për matjen e kohës aktuale dhe hapave të kërkuar nga mbërritja e mallrave deri në zhdoganimin dhe daljen e tyre në tregun e brendshëm. U vizituan të gjitha terminalët e brendshme dhe pikat e kalimit kufitar ku u krye Studimi i SMKZH-së, dhe doganierët, agjentët doganorë dhe operatorët e terminaleve u informuan rreth studimit. Përveç kësaj, përfaqësuesit e UBO Consulting dhe IFC-së u takuan edhe me AVUK-un për të diskutuar rreth çdo ndryshimi të mundshëm në hartëzimin e proceseve të punës. Megjithatë, procedurat e AVUK-ut në kufi nuk kishin pasur ndryshime.

Testimi pilot

Një testim pilot u zhvillua nga 8 nëntori deri më 10 nëntor 2021. Testimet pilot janë të rëndësishme për të konstatuar nëse mbledhja e të dhënave mund të bëhet siç është përshkruar. Ato ofrojnë gjithashtu mundësinë për të korrigjuar çdo problem që mund të haset për shkak të mungesës së mirëkuptimit nga personeli që mbledh dhe regjistron të dhënat. Objektivat specifike të testimit pilot ishin: - të përcaktohej nëse metodologjia e propozuar për mbledhjen e të dhënave do të funksiononte në mënyrë operative; dhe - të njiheshin ndërmjetësit me detyrat e tyre për plotësimin e pyetësorit të importit dhe eksportit.

Rezultatet e pilotimit treguan se pyetësori ishte i përshtatshëm dhe se plotësimi i tij do të siguronte të dhënat e nevojshme për një analizë të kohës së nevojshme për zhdoganimin e mallrave.

Procesi i mostrimit

UBO Consulting dhe IFC vendosën të mos përdorin një metodologji të mostrimit, por të regjistrojnë të dhëna për të gjitha transaksionet e importit dhe eksportit, përfshirë ato që i nënshtroheshin Procedurave të Thjeshtëzuara. Kur SMKZH u krye për herë të parë në Kosovë në vitin 2016, nuk u regjistruan transaksionet e importit dhe eksportit që i nënshtroheshin Procedurave të Thjeshtëzuara.

Tabelat e mëposhtme tregojnë se sa pyetësorë janë mbledhur për çdo PKK dhe terminal të brendshëm.

Tabela 1. Shpërndarja e pyetësorëve në çdo Pikë të Kalimit Kufitar

Vendndodhja e PKK-së	Import	Eksport
Kufiri me Serbinë	147	14
Kufiri me Maqedoninë e Veriut	437	166
Kufiri me Shqipërinë	543	22
Gjithsej	1127	202

Tabela 2. Shpërndarja e pyetësorëve në çdo terminal të brendshëm

Vendndodhja e terminaleve të brendshëm	Import	Eksport
Prizren	141	4
Hani i Elezit	84	29
Prishtinë	140	7
Ferizaj	104	51
Gjithsej	469	91

Analiza e të dhënave

Siç tregohet më lart në Tabelën 1, numri i përgjithshëm i pyetësorëve të mbledhur për import ishte 1127, kurse për eksport ishte 202. Të dhënat nga këta pyetësorë u futën në sistemin për SMKZH të OBD-së. Softueri për SMKZH i OBD është dizajnuar për të prodhuar raporte validimi të të dhënave. Ky program u ekzekutua për të identifikuar çdo anomali dhe çdo gabim i identifikuar u korrigjua. Të gjithë pyetësorët u kontrolluan për të siguruar saktësinë e të dhënave të raportuara.

Gjetjet

Import

Kjo pjesë e raportit paraqet gjetjet kryesore të studimit si për import ashtu edhe për eksport. Tabelat dhe grafikët tregojnë krahasimet e kohëve mesatare për intervalet kryesore të procesit të importit dhe eksportit për vitin 2016 dhe 2021.

Tabela e mëposhtme paraqet gjetjet e përgjithshme në procedurat e importit. Sipas rezultateve të studimit, nga mbërritja në PKK një kamioni i duhen mesatarisht 3 orë e 19 minuta për të marrë urdhrin e zhdoganimit, krahasuar me 5 orë e 3 minuta në vitin 2016. Gjithashtu, koha nga mbërritja e kamionit në PKK deri në daljen e kamionit nga PKK-ja është ulur nga 6 minuta në vitin 2016 në 3 minuta në vitin 2021.

Të dhënat tregojnë se koha nga mbërritja e kamionit në терминалет e brendshme deri në lëshimin e urdhrin të zhdoganimit është rritur nga 4 orë e 3 minuta në 2016 në 6 orë e 34 minuta në 2021. Kjo është për shkak të orarit të punës të terminaleve, çka rezulton në mospërfundimin e procedurës brenda një dite ose nevojën për të pritur për përpunimin e ditës tjetër.

Tabela 3. Gjetjet e përgjithshme - Importi

Intervali	Viti	Koha mesatare	Ndryshimi i përqindjes	Numri i përgjigjeve valide	Numri i pyetjeve që përcaktojnë intervalin
Mbërritja e kamionit në PKK deri në nxjerrjen e Urdhrit të Zhdoganimit	2016	5 orë 3 minuta	-34.3%	382	10 deri 73
	2021	3 orë 19 minuta		1127	
Mbërritja e kamionit në PKK deri në daljen e kamionit nga PKK-ja	2016	0 orë 6 minuta	-50%	427	10 deri 24
	2021	0 orë 3 minuta		1127	
Mbërritja e kamionit në terminalin e brendshëm deri në nxjerrjen e Urdhrit të Zhdoganimit	2016	4 orë 3 minuta	+60.2%	373	27 deri 73
	2021	6 orë 34 minuta		470	

Të dhënat nga SMKZH 2021 tregojnë se ka një ulje të kohës mesatare për përpunimin e kanalit të kuq doganor duke përfshirë kontrollin e dokumenteve dhe ekzaminimet fizike në të gjitha terminalet e brendshme, nga 2 orë e 58 minuta në 2016 në 2 orë. Krahës kësaj, ka edhe një ulje të kohës së përgjithshme mesatare vetëm për ekzaminimet fizike të kanalit të kuq doganor, në të gjitha terminalet e brendshme, nga 25 minuta në 2016 në 12 minuta në 2021.

Figura 1. Koha mesatare e kërkuar për intervalet kryesore të procesit të importit

SMKZH mati edhe proceset individuale të importit. Të dhënat tregojnë se kontrolli i policisë kufitare zgjat më pak se 1 minutë. Koha mesatare nga momenti kur vozitësi dorëzon dokumentacionin në doganë deri në përfundimin e kontrollit të kabinës është 3 minuta. Gjithashtu, koha mesatare nga fillimi i kontrollit të dokumentacionit nga agjencitë e tjera qeveritare deri në përfundimin e tij është 55 minuta. Së fundi, u mat edhe procesi që plotësojnë shpeditërit. Koha mesatare nga verifikimi i T1 në softuerin doganor në ASYCUDA deri në lëshimin e Urdhrit të Zhdoganimit është 5 orë e 47 minuta.

Figura 2. Koha mesatare për proceset individuale të importit

Grafiku i mëposhtëm tregon kohën mesatare nga momenti kur kamioni arrin në terminalin e brendshëm deri në Urdhrin e Zhdoganimit për kanalin e gjelbër dhe atë të kuq. Kamionëve që kalojnë përmes kanalit të gjelbër u duhet mesatarisht 6 orë e 28 minuta për t'i përfunduar procedurat, ndërsa atyre që kalojnë në kanalin e kuq mesatarisht 8 orë e 48 minuta.

Figura 3. Koha mesatare nga momenti kur kamioni mbërrin në terminalin e brendshëm deri në Urdhrin e Zhdoganimit - Kanali i Gjellbër kundrejt Kanalit të Kuq

Procedurat e Pikës së Kalimit Kufitar

Koha nga mbërritja e kamionit në PKK deri në daljen e kamionit nga PKK-ja është ulur nga 6 minuta në vitin 2016 në 3 minuta në vitin 2021. Megjithatë, duhet të kihet parasysh se studimi i SMKZH në vitin 2016 nuk ka përfshirë dërgesat që janë përpunuar në kuadër të procesit të Procedurave të Thjeshtëzuara, i cili u lejon kamionëve të kalojnë drejtpërdrejt nga PKK-ja në ambientet e importuesit dhe të dalin në treg menjëherë. Në studimin aktual, rreth 58 për qind e dërgesave u përpunuan sipas Procedurave të Thjeshtëzuara². Të dhënat tregojnë se një kamioni i cili përpunohet sipas Procedurave të Thjeshtëzuara i duhen mesatarisht 2 minuta për të përfunduar procedurat në Pikat e Kalimit Kufitar. Procedurat e thjeshtëzuara mund ta bëjnë trajtimin doganor të mallrave të importuara shumë më pak të komplikuar dhe gjithashtu, sipas llojit të procedurës, më të kursyer në kohë. Sipas rezultateve të studimit, dërgesat me shumicë, si çimentoja, xeherori i nikelit dhe klinkeri, zakonisht përpunohen sipas procedurave të thjeshtëzuara, ndërsa kamionët që përmbajnë produkte nafte dhe gazi kanë më shumë gjasa të drejtohen në терминалет e brendshme. Megjithatë, procedurat e thjeshtëzuara zbatohen edhe për mallrat e tjera. Procedura e Thjeshtëzuar e Deklarimit jepet për ngarkesat e mallrave që kanë numër tarifor, karakteristika teknike dhe nomenklaturë tregtare të të njëjtit lloj; që identifikohen lehtësisht dhe që për mallrat e tilla nuk kërkohen dokumente shtesë për t'u klasifikuar në përputhje me Tarifën e Integruar të Kosovës (TARIK) ose për përcaktimin e origjinës si dhe pranimin e vlerës së paraqitur në faturë.

Mesatarja e përgjithshme, nga momenti kur kamioni arrin në PKK deri në lëshimin e urdhrin për zhdoganim është 3 orë e 19 minuta. Koha mesatare për zhdoganimin me procedura të thjeshtëzuara (58% e gjithsej rasteve) është dy minuta, ndërsa e atyre kamionëve që kanë kaluar në procedura të rregullta (42% e totalit të rasteve) është 7 orë e 55 minuta.

Figura 4. Koha mesatare e kërkuar nga mbërritja e kamionit deri në Urdhrin e Zhdoganimit - procedurat e thjeshtëzuara dhe të rregullta

Procedurat e Terminalit të Brendshëm

Koha mesatare nga mbërritja e kamionit në terminalin e brendshëm deri në nxjerrjen e urdhrin të zhdoganimit është rritur për 2 orë e 31 minuta - nga 4 orë e 3 minuta në 2016 në 6 orë e 34 minuta në 2021. Rreth 36 për qind e kamionëve që kanë shkuar në терминалет e brendshme u është dashur ta vazhdojnë procesin ditën e nesërme për shkak të mbylljes së terminaleve në orën 18:00, dhe të dhënat tregojnë se këta kamionë shkaktojnë një rritje të kohës mesatare të përgjithshme për procedurat e zhdoganimit të terminalit të brendshëm. Kamionët që përpunohen në të njëjtën ditë kur hyjnë në terminalin e brendshëm, zhdoganohen mesatarisht për 2 orë e 11 minuta. Nga ana tjetër, kamionët që vazhdojnë me procesin ditën e nesërme, kanë një kohë mesatare zhdoganimi prej 14 orësh e 18 minutash.

² Shkoni te Shtojca 9 për një përmbledhje të procedurave të thjeshtëzuara

Figura 5. Koha mesatare e kërkuar nga mbërritja e kamionit në terminalin e brendshëm deri në nxjerrjen e Urdhrit të Zhdoganimit

Eksporti

Tabela e mëposhtme tregon gjetjet e përgjithshme për procesin e eksportit. Koha mesatare nga momenti kur agjenti depoziton DUD-in në Dogana deri kur kamioni del nga PKK-ja është ulur nga 3 orë e 17 minuta në 2016 në 2 orë e 44 minuta në 2021. Megjithatë, ka pasur një rritje prej 9 minutash në kohën mesatare nga momenti kur agjenti depoziton DUD-in në Doganë në terminalin e brendshëm deri kur kamioni del nga terminali, nga 33 minuta në 2016 në 42 minuta në 2021.

Ndryshimi më i rëndësishëm në kohën mesatare ka qenë nga koha e paraqitjes së dokumentacionit në PKK deri në vulosjen e kamionit dhe përditësimin e ASYCUDA, nga 1 orë e 10 minuta në 2016 në 5 minuta në 2021. Megjithatë, të dhënat e vitit 2021 tregojnë se vetëm 7.4 për qind të kamionëve iu kërkuar të kryenin kontroll fizik dhe nuk u zbuluan shkelje doganore.

Tabela 4. Gjetjet e përgjithshme - Eksporti

Intervali	Viti	Koha mesatare	Ndryshimi i përqindjes	Numri i përgjigjeve valide	Numri i pyetjeve që përcaktojnë intervalin
Koha nga dorëzimi i DUD-it në Doganë në terminalin e brendshëm deri kur kamionin del nga PKK-ja	2016	3 orë 17 minuta	-16.8%	251	9 deri 49
	2021	2 orë 44 minuta		91	
Koha nga dorëzimi i DUD-it në Doganë në terminalin e brendshëm deri kur kamionin del nga PKK-ja	2016	0 orë 33 minuta	+37.3%	100	9 deri 35
	2021	0 orë 42 minuta		90	
Koha nga paraqitja e dokumentacionit në PKK deri në vulosjen e kamionit dhe përditësimin e ASYCUDA	2016	1 orë 10 minuta	-92.9%	244	37 deri 45
	2021	0 orë 5 minuta		193	38 deri 45

Siç shihet në grafikun më poshtë, koha mesatare nga mbërritja e kamionit në терминаlet e brendshme deri në përfundimin e ekzaminimit fizik është ulur nga 51 minuta në 2016 në 50 minuta në 2021. Përveç kësaj, vërehet një rënie tjetër për një minutë nga koha e përfundimit të ekzaminimit fizik deri në momentin kur vulozet kamioni dhe përditësohet ASYCUDA.

Figura 6. Koha mesatare e kërkuar për intervalet kryesore të procesit të eksportit

Koha mesatare që u duhet shpeditërëve nga momenti kur agjenti dorëzon DUD-in në Doganë deri në vendosjen e vulës dhe futjen e informacionit në softuerin e doganës, është 2 orë e 31 minuta. Përveç kësaj, koha mesatare për doganën për ta përfunduar procesin nga koha kur vozitësi dorëzon dokumentacionin në Doganë, është 5 minuta. Për fundi, policisë i duhen mesatarisht 2 minuta për të kryer kontrollin në pikën kufitare.

Figura 7. Koha mesatare për proceset individuale të eksportit

Kohët e përpunimit të lejes veterinare të AVUK-ut

Për produktet bimore dhe shtazore që hyjnë në Kosovë kërkohet leje importi dhe aprovim nga AVUK-u. Ligji i Kosovës kërkon që përpunimi nga AVUK të bëhet para zhdoganimit. Për të siguruar që të gjitha ngarkesat që kërkojnë përpunim nga AVUK-u të aprovohen nga AVUK-u përpara liritimit, Dogana i ka të referuara në ASYCUDA kodet tarifore që lidhen me kërkesat e AVUK-ut dhe nuk i zhdoganon ngarkesat me ato kode nëse nuk ka një vulë të AVUK-ut në deklaratë që tregon aprovimin nga AVUK-u.

Nëpërmjet këtij studimi ne llogarisim edhe kohën e nevojshme për marrjen e vërtetimit të lejes nga AVUK. Sipas të dhënave nga 27 kamionë që importonin ushqime apo produkte shtazore, AVUK-ut i duhen mesatarisht 5 orë për të lëshuar një leje importi.

Reagime nga regjistruarit

Regjistruarit nga UBO Consulting ndanë përvojën e tyre nga procesi i mbledhjes së të dhënave për Studimin për Matjen e Kohës së Zhdoganimit. Të gjithë regjistruarit ishin të mendimit se përvoja e përgjithshme gjatë këtij studimi ishte e shkëlqyer. Sipas tyre, doganierët dhe policia në pikat kufitare kanë qenë shumë bashkëpunues dhe ndihmues. Megjithatë, ka pasur disa ankesa për shpeditërët që nuk ishin shumë bashkëpunues gjatë fazës së testimit pilot të projektit.

Konkluzionet dhe rekomandimet

Rekomandime nga viti 2016

Në planin afatshkurtër:

- Të zgjerohet numri i mallrave/tregtarëve të autorizuar për të përdorur procedurat e thjeshtëzuara të lirimt;
- Të zgjerohet orari i punës në терминаlet e brendshme (disa nga rezultatet skajore ishin për shkak të transportuesve që mbërrinin në terminal në fund të ditës);
- Të sigurohet zbatim uniform i politikës dhe procedurave duke i shqyrtuar procedurat në терминаlet e brendshme, pasi ka pjesërisht mospërputhje të rëndësishme mes terminaleve në lidhje me kohën e përdorur për procedura të ndryshme.

Në planin afatmesëm dhe afatgjatë:

- Të vazhdohet puna dhe të zbatohet Programi për Operatorë të Autorizuar Ekonomikë (OAE) që është aktualisht në zhvillim e sipër. Me futjen e këtij program, kamionët do ta anashkalojnë terminalin e brendshëm dhe do të vazhdonin drejtpërdrejt në ambientet e tregtarëve;
- Të zhvillohet një sistemi i vetëm dhe i unifikuar TIK me ndërlidhje ndërmjet Doganës së Kosovës dhe Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë. Kjo do të ndihmonte në eliminimin e kërkesës për kopje fizike të dokumenteve dhe do të ndihmonte në zvogëlimin e kohës së nevojshme për përpunimin e AVUK-ut, pasi kjo mund të bëhet online duke rezultuar në aprovimin online;
- Të konsiderohet ndarja e lirimt nga pagesa e detyrimit (një shtyrje e pagesës së detyrimeve bazuar në garancitë e postuara);
- Të konsiderohet zhvillimi i një dritareje të vetme elektronike për të lehtësuar dhënien e licencave, lejeve dhe vërtetimeve.

Të dhënat nga SMKZH-ja e vitit 2021 tregojnë se është adresuar rekomandimi i parë nga SMKZH-ja e vitit 2016, i cili ishte zgjerimi i numrit të mallrave/tregtarëve të autorizuar për të përdorur Procedurat e Thjeshtëzuara të Zhdoganimit, pasi 58.3 për qind e mallrave i nënshtroheshin procedurave të thjeshtëzuara.

Nga ana tjetër, orari i punës në терминаlet e brendshme vazhdon të përbëjë sfidë. Rreth 36 për qind e kamionëve që mbërrijnë në terminalin e brendshëm pas orës 18:00 duhet të presin për ta nisur të nesërmen procesin e lirimt.

- Rekomandohet që në mënyrë që të zvogëlohet koha nga mbërritja e kamionit në terminalin e brendshëm deri në nxjerrjen e urdhrat të zhdoganimit, numri i orëve të punës në терминаlet e brendshme duhet të jetë më i gjatë.
- Gjithashtu, orari i punës i agjencive kufitare nuk është i harmonizuar. Për shembull, orari i punës së terminalit të AVUK-ut është nga ora 08:00 – 16:00, ndërsa Dogana punon nga ora 08:00 – 18:00.

Të dhënat tregojnë se терминаlet e brendshme në Prizren dhe Han të Elezit kanë kohë më të shkurtër përpunimi se терминаlet e brendshme në Prishtinë dhe Ferizaj. Gjithashtu, rezultatet e studimit tregojnë se kufijtë me Shqipërinë dhe Maqedoninë kanë kohë më të shkurtër përpunimi se kufiri me Serbinë.

- Dogana e Kosovës duhet të vazhdojë të punojë drejt aplikimit uniform të procedurave.

- Duhet të zhvillohet një sistem/softuer i vetëm për të siguruar shkëmbimin e informacionit ndërmjet agjencive kufitare.

Edhe pse të dhënat nga SMKZH 2021 tregojnë se ka një ulje të kohës mesatare për përpunimin e kanalit të kuq doganor duke përfshirë kontrollin e dokumenteve dhe ekzaminimet fizike në të gjitha терминаlet e brendshme, nga 2 orë e 58 minuta në 2016 në 2 orë, rekomandohet që Dogana e Kosovës të fokusohet në reduktimin e kohës së nevojshme për këtë pjesë të procedurës. Nëse për ekzaminimin fizik të ngarkesave nevojiten mesatarisht vetëm 12 minuta, mbetja prej 1 orë e 48 minutash “shpenzohen” për kontrollin e dokumenteve dhe vlerësimin doganor të mallit, që përfaqëson periudhën kohore më të gjatë në të gjithë procedurën e zhdoganimit.

Rekomandime të tjera për shqyrtim

Të krijohet një Dritare e Vetme Kombëtare (DVK): Objektivi kryesor i një Dritareje të Vetme është të lehtësojë tregtarët në përmbushjen e të gjitha detyrimeve rregullatore (licencat, lejet dhe vërtetimet dhe autorizimet e tjera) në lidhje me importin ose eksportin me autoritetet përkatëse të vendit të tyre nëpërmjet një pike të vetme hyrjeje online. Projektet e DVK-së ofrojnë përfitime të rëndësishme për lehtësimin e tregtisë duke siguruar integritet dhe transparencë më të madhe, si dhe duke bërë ndarjen më efektive dhe efikase të burimeve dhe duke reduktuar e kohën. Këto përfitime janë si për *qeverinë* - përmes përmirësimit të pajtueshmërisë tregtare, sigurisë së shtuar dhe të ardhurave korrekte dhe shpeshherë të rritura, ashtu edhe për *tregtarët* - përmes zhdoganimit dhe lirimit më të shpejtë, aplikimit të parashikueshëm dhe shpjegimit të rregullave, uljes së mundësive për interpretim të ligjeve dhe rregulloreve dhe, përfundimisht, uljes së kostove nëpërmjet reduktimit të vonesave dhe pagesave informale. Qeveria e Kosovës duhet të përpikët që në Kosovë të zbatohet një instrument i tillë. Këtë mundësi do ta ofrojë operacioni i Bankës Botërore i Huasë për Lehtësimin e Tregtisë dhe Transportit.

Të kryhen një shqyrtim gjithëpërfshirës i tarifave dhe ngarkesave të lidhura me tregtinë për të siguruar që ato të vendosen në përputhje me parimet e MLT-së. Shumica e tarifave dhe ngarkesave për licenca kanë qenë në fuqi për 5 ose 10 vjet pa auditim ose rishikim. Qëllimi i rishikimit është gjetja e mundësive për uljen ose eliminimin e tarifave dhe ngarkesave që nuk janë në përputhje me standardet më të mira dhe i shtojnë kosto të panevojshme sektorit privat.

Të eliminohet Tarifa e Terminalit: Dogana e Kosovës nuk ofron zhdoganim të mallrave në kufi. Çdo kamion (përveç OAE-ve dhe kompanive që janë në regjimin e procedurave të thjeshtëzuara) është i detyruar të hyjë në një terminal të brendshëm që është në pronësi private dhe të paguajë një tarifë prej 40 eurosh. Edhe pse sistemi ASYCUDA do ta kategorizojë pjesën më të madhe të ngarkesave për “kanal të gjelbër”, pra për lirim menjëherë pas hyrjes në terminal pa inspektim, kamionët janë ende të detyruar ta paguajnë tarifën e hyrjes. Procedura po krijon kosto të panevojshme për sektorin privat dhe po ashtu sjell vonesa në kohë. GBB dhe Bashkimi Evropian e kanë ngritur këtë çështje në mënyrë të përsëritur.

Krijimi i një njësie për menaxhimin e riskut në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë: Agjencia Ushqimit dhe Veterinarisë e Kosovës është e vetmja agjenci kufitare që ende nuk e ka themeluar dhe funksionalizuar njësinë e riskut në kuadër të agjencisë. Një nga sfidat kryesore për logjistikën tregtare të ushqimeve dhe ushqimit për kafshë në Kosovë lidhet me nivelin e lartë të inspektimeve teknike, dhe me frekuencën e ekzaminimeve fizike, marrjes së mostrave dhe testeve laboratorike. Ato shpesh janë burim vonesash dhe kosto shtesë për bizneset, veçanërisht gjatë importit. Arsyeja kryesore për një nivel kaq të lartë të ekzaminimit fizik dhe testimit është mungesa ose përdorimi i

pamjaftueshëm i menaxhimit të riskut për inspektime dhe për identifikimin e ngarkesave me një rregullore të nivelit më të lartë për riskun e cila lejon krijimin e një njësie risku në agjenci, e cila do ta udhëheqë formalisht përditësimin e informacionit mbi riskun dhe zhvillimin e planeve vjetore të monitorimit. Standardet ndërkombëtare kërkojnë që të gjitha agjencitë kufitare të krijojnë një Njësi të Riskut që çdo vit e vlerëson dhe zhvillon planin e riskut.

Të zbatohen Kontrollat të Përbashkëta Kufitare: Në asnjë kufi të Kosovës nuk ka objekt të kontrollit të përbashkët kufitar. Kamionët duhet të kalojnë dy formalitete kufitare, një në vendin e eksportit dhe një në vendin e importit. Sipas konceptit të Menaxhimit të Integruar të Kufirit (MIK), rekomandohet që kontrollet e dokumenteve dhe inspektimet në pikat e kalimit të kufirit të kryhen së bashku me autoritetet fqinje. Kontrollet e përbashkëta për ngarkesat ndihmojnë në eliminimin e tepricave, shkurtojnë kohën e pritjes në kufi dhe zvogëlojnë koston për sektorin privat. Struktura aktuale në Portin e Durrësit duhet të funksionalizohet plotësisht. Kosova duhet gjithashtu të përpiqet të vendosë kontrolle të përbashkëta në Merdare (Serbi) dhe Morinë (Shqipëri) – këto janë vendkalimet më të ngarkuara.

Të lidhen sistemet e TI-së të agjencive kufitare të Kosovës: Ekziston një Memorandum i Mirëkuptimit formal për bashkëpunim ndërmjet tri agjencive kryesore kufitare të pranishme në kufi. Bashkëpunimi bëhet në nivel Shtabi, si dhe në pikat kufitare, ku bashkëpunimi zhvillohet në formën e inspektimeve të përbashkëta. Takimet e rregullta të agjencive kufitare mbahen një herë në dy javë. Gjithashtu po zhvillohen takime të rregullta të përbashkëta me autoritetet e kontrollit kufitar në shtetin fqinj. Megjithatë, shkëmbimi i të dhënave ndërmjet agjencive kufitare bëhet përmes Qendrës Kombëtare për Menaxhim Kufitar vetëm në bazë të kërkesave. Secila agjenci kufitare ka sistemin e vet të brendshëm operativ të TI-së, dhe sistemet nuk janë të lidhura me njëri-tjetrin.

Shtojca 1: Dogana e Kosovës sot

Historiku dhe konteksti

Kosova është pjesë e Gadishullit Ballkanik në Evropën Juglindore. Kufizohet me Maqedoninë dhe Shqipërinë në jug, Malin e Zi në perëndim, dhe Serbinë në veri dhe lindje.

Shërbimi Doganor i UNMIK-ut u themelua në gusht të vitit 1999, për të siguruar zbatimin e rregullave doganore të drejta dhe uniforme dhe dispozitave të tjera të aplikueshme për mallrat, të cilat i nënshtrohen mbikëqyrjes doganore. Më 12 dhjetor 2008 Shërbimi Doganor i UNMIK-ut u bë Dogana e Kosovës. Kodi i ri Doganor u miratua më 11 nëntor 2008 nga Kuvendi i Kosovës. Kodi Doganor është në përputhje të plotë me standardet ligjore të Bashkimit Evropian dhe ndër të tjera ka për objektiv zhvillimin ekonomik të Republikës së Kosovës.³

Përveç detyrimeve doganore, Dogana mbledh edhe TVSH-në dhe akcizën. Përveç mbledhjes së të hyrave, Dogana e Kosovës mbron shoqërinë nga kontrabanda e drogës dhe mallrave të tjera të ndaluara.⁴

Kosova filloi t'i organizojë pikat e saj kufitare me ndihmën e administratës së përkohshme të Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) dhe Bashkimit Evropian (BE) në vitin 1999. Sot në gjithë Kosovën funksionojnë 13 pika kufitare dhe 10 terminale të brendshme me 622 të punësuar.

Pikat e kalimit kufitar të përdorura për SMKZH-në e Kosovës:

Pika e Kalimit Kufitar në Han të Elezit - gjendet në pjesën jugore të Republikës së Kosovës, në kilometrin e 70-të të autostradës Prishtinë-Shkup, Maqedoni. Është stacioni doganor me hyrjen më të madhe të udhëtarëve, automjeteve dhe kamionëve që bartin mallra komerciale për tregjet e Kosovës. Hani i Elezit përfshin dy pjesë ku kryhen operacionet e Doganës së Kosovës: Pikën e Kalimit Kufitar dhe Terminalin.⁵

Pika e Kalimit Kufitar në Vërmicë – pikë zyrtare e kalimit të kufirit ndërkombëtar ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë. Është e vetmja pikë e kalimit kufitar ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë që u shërben mallrave komerciale dhe ka volumin më të madh të pasagjerëve që hyjnë apo dalin nga Shqipëria.⁶

Pika e Kalimit Kufitar në Merdare – gjendet në kilometrin e 37-të të autostradës Prishtinë – Nish, Serbi, në verilindje të Kosovës. Filloi të funksionojë në vitin 2001. Në vitin 2002 në Podujevë u hap një terminal doganor për të përfunduar zhdoganimin e mallrave, ndërsa pika e kalimit kufitar merret me kontrolle të dokumenteve dhe zhdoganon mallrat që gjenden në bagazhet e pasagjerëve.⁷

³ Ueb faqja zyrtare e Doganës së Kosovës

⁴ Ueb faqja zyrtare e Doganës së Kosovës

⁵ Ueb faqja zyrtare e Doganës së Kosovës

⁶ Ueb faqja zyrtare e Doganës së Kosovës

⁷ Ueb faqja zyrtare e Doganës së Kosovës

Shtojca 2: Përpunimi doganor

Pasqyra e procesit të zhdoganimit nga Dogana

Dogana e Kosovës përdor ASYCUDA World si sistem të përpunimit të deklaratave. Deklaratat dorëzohen në mënyrë elektronike në Dogana për përpunim. Megjithatë, kur kërkohet liri nga AVUK ose ekzaminimi fizik nga Dogana, agjentit i kërkohet të dorëzojë kopje fizike në njësinë përkatëse.

Dogana e Kosovës ka dy forma të zhdoganimit të cilat diktojnë se ku do të zhvillohen procedurat e zhdoganimit. Dogana ka zbatuar procedura të thjeshtëzuara për deklarues të caktuar dhe mallra të caktuara (shih Shtojcën 9). Mallrat që i nënshtrohen procedurave të thjeshtëzuara zhdoganohen në pikën e kalimit kufitar (PKK) dhe mund të kalojnë drejtpërdrejt në ambientet e tregtarit.

Mallrat që nuk i nënshtrohen procedurave të thjeshtëzuara transportohen në терминаlet e brendshme për zhdoganim. Tregtari mund të zgjedhë që mallrat e tij të zhdoganohen në çdo terminal të brendshëm. Терминаlet e brendshme janë në pronësi private. ASYCUDA World i kategorizon deklaratat në tre kanale (si import ashtu edhe eksport) në varësi të analizës së riskut. Kanali i **gjelbër** tregon lirim të menjëhershëm pa ndërhyrjen e Doganës (deklaratat që mbulojnë mallrat që i nënshtrohen procedurave të thjeshtëzuara trajtohen si kanal i gjelbër); deklaratat në **kanalin e verdhë** kërkojnë shqyrtim të dokumenteve nga Dogana; **kanali i kuq** tregon se mallrat e mbuluara nga deklarata kërkojnë ekzaminim fizik.

Shtojca 3: Përpunimi i importit dhe eksportit

Përpunimi i importit

Në PKK kryhen hapat e mëposhtëm:

- Me mbërritjen e dërgesës në PKK, kryhen kontrolle policore duke përfshirë kontrollet e imigracionit;
- Zyrtari doganor verifikon që T1 (T1 është një dokument tranziti që përdoret për të transportuar mallra nën garanci nga një zyrë doganore në tjetrën - përdoret si për tranzit të brendshëm vendor ashtu edhe për transit ndërkombëtar) është në sistem; nëse nuk është, dërgesa mbahet derisa të dorëzohet një T1;
- Dërgesat mund të peshohen nëse është e nevojshme, dhe peshat regjistrohen;
- Kontrollet fizike të kabinës mund të bëhen nëse doganieri e konsideron të nevojshme;
- Transporti lirohet nga PKK-ja - nëse deklaruesi dhe mallrat e importuara kualifikohen për procedura të thjeshtëzuara, transporti qëndron në zonën e PKK-së për një kohë minimale dhe nëse nuk ka ndërhyrje të mëtejshme doganore brenda kësaj vonese kohore, mund të vazhdojë për në ambientet e importuesit;
- Për ngarkesat që nuk kualifikohen për procedura të thjeshtëzuara, transporti lirohet nga PKK-ja dhe vazhdon në terminalin e brendshëm.




Figura 7. Përpunimi në PKK

Në terminalët e brendshme kryhen hapat e mëposhtëm:

- Operatori i terminalit konfirmon mbërritjen e dërgesës në terminal;
- Shpediteri konfirmon T1 dhe regjistron manifestin;
- Nëse dërgesa kërkon lirim nga AVUK, DUD-i në kopje fizike dorëzohet në njësinë përkatëse të AVUK-ut për lirim – Inspektori i AVUK-ut kryen kontrollin e dokumentacionit dhe tregon nëse kërkohet ekzaminim fizik – Inspektori i AVUK-ut e vulos DUD-in për të treguar se deklarata është shqyrtuar;
- DUD-i regjistrohet në AW;
- Deklarata i nënshtrohet vlerësimit/selektivitetit të riskut të ASYCUDA WORLD;
- Deklaratat në kanal të GJELBËR kanalizohen në kanalin e kaltër, lëshohet urdhërpagesa, merret pagesa, shënimi i daljes krijohet në AW dhe printohet nga shpediteri, dërgesa vazhdon në portën e daljes, verifikohet dokumentacioni dhe dërgesa del nga terminali;
- Deklaratat në kanal të VERDHË - dërgesa qëndron në terminal për të lejuar kohë për shqyrtimin e dokumenteve dhe zgjidhjen e çdo pyetjeje. Jo të gjitha deklaratat në kanale të verdhë i nënshtrohen shqyrtimit të dokumenteve - nëse dosja nuk hapet në kohën e caktuar prej pesë minutash, dërgesës i lejohe të largohet nga terminali. Pasi të përfundojë përpunimi i kanalit të verdhë, deklaratat dërgohen në kanalin blu, lëshohet urdhërpagesa, merret pagesa, shënimi i daljes krijohet në AW dhe printohet nga shpediteri, dërgesa vazhdon në portën e daljes, verifikohet dokumentacioni dhe dërgesa del nga terminali; SHËNIM – ekziston një njësi shtabi të cilës i caktohet rastësisht një përqindje e deklaratave të kanalit të verdhë për shqyrtim të plotë të dokumenteve.
- Deklaratat në kanal të KUQ – kryhet ekzaminimi fizik i ngarkesës; plotësohet raporti i inspektimit dhe deponohet në AW; nëse zbulohen shkelje, dërgesa mbahet në terminal dhe ndërmerren veprimet për shkeljen; pasi të zgjidhet çdo pyetje që del si rezultat i ekzaminimit fizik, deklaratat dërgohen në kanalin e kaltër, lëshohet urdhërpagesa, merret pagesa, shënimi i daljes krijohet në AW dhe printohet nga shpediteri, dërgesa vazhdon në portën e daljes, verifikohet dokumentacioni dhe dërgesa del nga terminali.




Figura 8. Importi - përpunim në terminal të brendshëm

Përpunimi i eksportit

- Deklarata dorëzohet në mënyrë elektronike;
- Deklarata i nënshtrohet vlerësimit/selektivitetit të riskut të ASYCUDA WORLD;
- Deklaratat në kanalin e GJELBËR drejtohen për në dalje nga PKK-ja; vulozet dërgesa dhe futet informacioni në AW; dërgesa vazhdon drejt daljes nga PKK-ja; mbyllet deklarata e eksportit në AW;
- Deklaratat në kanalin e KUQ - transporti drejtohet në terminalin e brendshëm të specifikuar në DUD; kryhet ekzaminimi i dokumenteve dhe fizik; bëhen pyetje kur është e nevojshme dhe zgjidhen; ndërmerren veprime kundër shkeljeve ku është e justifikuar; dërgesa vazhdon drejt daljes nga PKK-ja; mbyllet deklarata e eksportit në AW.




Figura 9. Përpunimi i deklaratës së eksportit

Shtojca 4: Pyetësori për importin

STUDIMI I KOHËS SË ZHDOGANIMIT - STUDIMI I KOHËS SË ZHDOGANIMIT TË IMPORTEVE NË KOSOVË 2021/"VREMENSKA STUDIJA – VREMENSKA STUDIJA ZA KOSOVO – UVOZ ZA 2021./TIME RELEASE STUDY - KOSOVO TIME RELEASE STUDY - IMPORT 2021

Qëllimi i Anketës/Svrha studije/Purpose of Survey

Qeveria e Kosovës ka vendosur të kryejë një studim të plotë të Kohës së Zhdoganimit për procedurat e impoFVA

rtit dhe eksportit. Qëllimi i këtij studimi është të identifikojë pengesat në procedura për të ndërmarrë veprime korrigjuese. E vlerësojmë shumë bashkëpunimin tuaj në këtë studim.

Vlada Kosova je odlučila da sprovede potpunu vremensku studiju za postupke uvoza i izvoza. Svrha studije je identifikacija prepreka u postupcima kako bi se preduzele korektivne mere. Hvala Vam na učešću u ovoj studiji.

The Government of Kosovo has decided to conduct a full Time Release Study for import and export procedures. The purpose of this study is to identify the bottlenecks in the procedures order to take corrective action. Your cooperation in partaking in this study is appreciated.

SEKSIONI A - TË DHËNAT TRS/ODELJAK A – PODACI O TRS/SECTION A- TRS DATA

1. Emri i Importuesit/Naziv uvoznika/Name of Importer	
2. Numri Unik Identifikues i Importuesit/ Jedinstveni identifikacioni broj uvoznika/Unique Importer Identification Number	
3. Emri i Agjentit/Naziv agenta/Name of Agent	
4. Numri Unik Identifikues i Agjentit/Jedinstveni identifikacioni broj agenta/Unique Agent Identification Number	
5. Numri i tabelave të kamionit /Registracijske tablice kamiona/Truck Licence Plates	
6. Përshkrimi i Ngarkesës/Opis robe/Cargo Description	
7. Numri T1/T1 broj/T1 Number	
8. Numri i Deklaratës Unike Doganore (DUD) /SAD broj/SAD number	

SEKSIONI B - ARRITJA E KAMIONIT NË PKK/ODELJAK B - DOLAZAK KAMIONA NA GRANIČNI PRELAZ (GP)
SECTION B - ARRIVAL OF TRUCK AT BCP

9. Lokacioni i PKK/Lokacija GP/ Location of BCP	Kufiri me Serbinë Granica sa Srbijom ☐ Serbia Border	Kufiri me Maqedoninë e Veriut/ Granica sa Severnom Makedonijom/North Macedonia Border	Kufiri me Shqipërinë ☐ Granica sa Albanijom Albania Border
10. Data dhe koha kur kamioni arrin në PKK/Datum i vreme dolaska kamiona na GP/Date and time the truck arrives at the BCP	data/datum/d _____ _____ muaji/mesec/mth _____ ora/čas/hr _____ min.		
11. Data dhe koha kur fillon kontrolli policor/Datum i vreme započinjanja policijske inspekcije/Date and time Police check commences	data/ datum _____ _____ /date _____ muaji/mesec/mth _____ ora/čas/hr _____ min.		
12. Data dhe koha kur mbaron kontrolli policor/Datum i vreme završetka policijske inspekcije/Date and time Police check ends	data/ datum _____ _____ /date _____ muaji/mesec/mth _____ ora/čas/hr _____ min.		
13. Data dhe koha kur shoferi paraqet dokumentacionin në Dogana/Datum i vreme kada je vozač predao dokumentaciju carinskoj službi/ Date and time driver submits documentation to Customs	data/ datum _____ _____ /date _____ muaji/mesec/mth _____ ora/čas/hr _____ min.		
